

Thirrje për Ekspert/e për Hartimin e Rregullores për Funkionimin e Brendshëm të Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP)

[Platforma CiviKos](#), në bashkëpunim me [Institutin për Teknologji dhe Shoqëri](#) (ITS) dhe në partneritet me [Agjencia për Informim dhe Privatësi](#) (AIP), hap thirrje për një ekspert/e të jashtëm për të hartuar një rregullore që do të përmirësojë operacionet e brendshme të AIP-së. Kjo thirrje është në kuadër të projektit "Përmirësimi i Mbrojtjes së të Dhënave dhe Sigurisë Kibernetike në të Gjitha Sektorët në Kosovë" mbështetur përmes programit MATRA, nga Ambasada Holandeze në Prishtinë.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Hartimi i rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në AIP;
- Bashkëpunimi me një grup pune të përbërë nga anëtarë brenda AIP-së për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse në hartimin e rregullores;
- Sigurimi që rregullorja të jetë efektive dhe e përshtatur për nevojat dhe sfidat unike të Agjencisë;
- Hartimi, adresimi i komenteve dhe dorëzimi i rregullores për miratim dhe aprovim nga Komisionerja;
- Ofrimi i mbështetjes për zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga rregullorja e miratuar duke përfshirë: përgatitjen dhe finalizimin e përshkrimeve të vendeve të punës në koordinim me menaxhmentin dhe Komisionin përkatës;
- Ofrimin e mbështetjes për Komisionin e Ristrukturimit sipas obligimeve nga rregullorja e re;
- Ofrimin e këshillave dhe opinioneve sipas kërkesës së Drejtores së Përgjithshme ose të Komisioneres së AIP-së.

Kualifikimet e Kërkuara:

- Fakulteti Juridik;
- Përvoja e punës: së paku 10 vite të përvojës profesionale;
- Përvojë në fushëveprimin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi;
- Përvojë e dëshmuar në hartim të legjislacionit të ngjashëm;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe bashkëpunimi;
- Aftësi për të ofruar njohuri të specializuara dhe perspektiva objektive.

Nëse jeni të interesuar dhe keni kualifikimet e nevojshme, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj, referencat për punët e mëhershme të ngjashme si kjo, si dhe një ofertë financiare për ditë pune në info@civikos.net deri më 20.06.2024.